

STATISTIKAT AFATSHKURTRA

Shërbimet, T1 - 2026

Treguesit tremujorë të shitjeve neto, punësimit dhe pagave për aktivitetet që bëjnë pjesë në sektorin e shërbimeve:

Indeksi i shitjeve neto në volum në tremujorin e parë 2026, krahasuar me tremujorin e parë 2025 paraqitet si më poshtë:

- Në aktivitetin Tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, indeksi shënoi rritje 4,6 %;
- Në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, indeksi shënoi ulje 3,8 %;
- Në aktivitetin Hotele, indeksi shënoi rritje 12,6 %;
- Në aktivitetin Bar-Restorante, indeksi shënoi rritje 8,4 %;
- Në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, indeksi shënoi ulje 1,6 %;
- Në aktivitetin Pasuritë e paluajtshme, indeksi shënoi rritje 31,5 %;
- Në aktivitetet Ligjore dhe të kontabilitetit, indeksi shënoi ulje 4,3 %;
- Në aktivitetet Arkitekturë dhe Inxhinierike, indeksi shënoi rritje 8,0 %;
- Në aktivitetin Agjenci udhëtimi, indeksi shënoi rritje 1,9 %;
- Në aktivitetet e Sigurimit dhe hetimit, indeksi shënoi rritje 4,9 %;
- Në aktivitetin Administrim zyrash, mbështetje administrative, indeksi shënoi ulje 5,4 %.

Indeksi i punësimit në tremujorin e parë 2026, krahasuar me tremujorin e parë 2025 paraqitet si më poshtë:

- Në aktivitetin Tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, indeksi shënoi rritje 3,6 %;
- Në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, indeksi shënoi rritje 3,3 %;
- Në aktivitetin Hotele, indeksi shënoi rritje 9,4 %;
- Në aktivitetin Bar-Restorante, indeksi shënoi rritje 1,9 %;
- Në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, indeksi shënoi rritje 2,1 %;
- Në aktivitetin Pasuritë e paluajtshme, indeksi shënoi rritje 22,5 %;
- Në aktivitetet Ligjore dhe të kontabilitetit, indeksi shënoi rritje 0,3 %;
- Në aktivitetet Arkitekturë dhe Inxhinierike, indeksi shënoi rritje 3,1 %;
- Në aktivitetin Agjenci udhëtimi, indeksi shënoi rritje 3,7 %;
- Në aktivitetet e Sigurimit dhe hetimit, indeksi shënoi ulje 3,2 %;
- Në aktivitetin Administrim zyrash, mbështetje administrative, indeksi shënoi ulje 10,5 %.

Indeksi i pagave në tremujorin e parë 2026, krahasuar me tremujorin e parë 2025 paraqitet si më poshtë:

- Në aktivitetin Tregti me shumicë, tregti me pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe motorçikletave, indeksi shënoi rritje 14,6 %;
- Në aktivitetin Transport, Magazinim dhe Postë, indeksi shënoi rritje 1,2 %;
- Në aktivitetin Hotele, indeksi shënoi rritje 22,0 %;
- Në aktivitetin Bar-Restorante, indeksi shënoi rritje 14,6 %;
- Në aktivitetin Informacion dhe Komunikacion, indeksi shënoi rritje 10,4 %;
- Në aktivitetin Pasuritë e paluajtshme, indeksi shënoi rritje 35,0 %;
- Në aktivitetet Ligjore dhe të kontabilitetit, indeksi shënoi rritje 6,1 %;
- Në aktivitetet Arkitekturë dhe Inxhinierike, indeksi shënoi rritje 12,2 %;
- Në aktivitetin Agjenci udhëtimi, indeksi shënoi rritje 20,5 %;
- Në aktivitetet e Sigurimit dhe hetimit, indeksi shënoi rritje 14,8 %;
- Në aktivitetin Administrim zyrash, mbështetje administrative, indeksi shënoi ulje 6,5 %.

FIG. 1 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË SHITJEVE NETO NË VOLUM (%)





FIG. 2 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË SHITJEVE NETO NË VOLUM (%)



TAB. 1 INDEKSI I SHITJEVE NETO NË VOLUM, SHËRBIME (2021=100)

NVE Rev.2		Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja		Tr.I. 2026 (2021=100)	I.26/ I.25 (%)	Tr. I 2026 (2021=100)	I.26/ IV.25 (%)
G	45+46 +47	Tregti	102,8	4,6	114,4	1,3
H	49-53	Transport dhe Magazinim	106,0	-3,8	129,5	-8,0
I	55,1	Hotele	120,0	12,6	203,2	2,4
I	56	Bar-Restorante	136,3	8,4	147,7	2,6
J	58, 60, 61, 62	Informacioni dhe Komunikacion	101,2	-1,6	113,3	-2,3
L	68	Aktivite të Pasurive të paluajtshme	183,6	31,5	171,5	1,5
M	69	Aktivite Ligjore dhe të kontabilitetit	120,1	-4,3	124,5	-2,9
M	71	Aktivite Arkitekture dhe Inxhinierike	87,9	8,0	103,5	2,2
N	79	Agjenci udhëtimi	176,3	1,9	236,0	-6,0
N	80	Aktivite të Sigurimit dhe hetimit	115,2	4,9	118,8	2,2
N	82	Administrim zyresh,mbeshtetje administrative	110,5	-5,4	111,3	-4,8

Shënim për përdoruesit: Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT:
[Statistikat Afatshkurtra – Shërbimet](https://www.instat.gov.al/)

Metodologjia

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve të Shërbimeve, janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46), Tregti me pakicë(47)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor: Hotele (55,1) dhe Bar-Restorante (56)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 60, 61, 62)
- Aktivitete të pasurive të paluajtshme (68)
- Aktivitete ligjore dhe te kontabilitetit (69)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)
- Agjenci udhëtimi (79)
- Aktivitete te sigurimit dhe hetimit (80)
- Administrim zyrash, mbështetje administrative (82)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2021=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash, Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres, Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtë vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shitjeve neto - Shitjet neto përfshijnë shumën e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me tregun e shitjes shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shitjeve neto - Objektivi i indeksit të Shitjeve neto është të paraqesë ecurinë e tregut për shërbime,

Numri i të punësuarve - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të Shërbimeve zbatohet duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënshpërbërjen X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori I 2026. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme, Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative).